



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:249951  
Datë: 10.02.2025  
Numri i dokumentit: 06828136

**C.nr.2386/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shaban Shala, me praktikanten gjyqësore E.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.S. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. Y.K. nga Prizreni, kundër të paditurit Y.L. nga Prizreni, për shkak të pengim posedimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik dhe fjalës përfundimtare, më datën **08.01.2025**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit **H.S.** nga Prizreni dhe **VËRTETOHET** se i padituri **Y.L.** nga Prizreni ka kryer aktin e pengim posedimit në dëm të paditësit, në mënyrë që në një pjesë të katit përdhësë dhe të katit të parë të objektit të tij i cili gjendet në ngastrën kadastrale 4342-1 ZK Prizren ka hapur dritaret ( e banjos me dimensione 60x60 cm dhe e ballkonit me dimensione 85 x 140 cm) kah shtëpia e paditësit që shtrihet në parcelën me nr. 4341 ZK Prizren, si dhe në katin e parë ka ndërtuar terasën që shtrihet mbi objektin e shtëpisë së paditësit.

**II. DETYROHET** i padituri **Y.L.** që paditësit t'ia kthejë posedimin në gjendjen e mëparshme, ashtu që ti mbyll menjëherë dritaret e hapura në objektin e tij kah shtëpia e paditësit të përshkruara sikurse në dispozitivin nën I, si dhe të rrënojë terasën në objektin e tij që shtrihet mbi objektin e shtëpisë së paditësit në parcelën 4341 ZK Prizren, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

**III.** Me shpenzimet procedurale obligohet i padituri, ndërsa obligohet që paditësit t'ia paguaj shpenzimet procedurale në lartësi prej 1,129.00 €.

**A r s y e t i m**

Paditësi H.S. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. Y.K. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit Y.L. nga Prizreni, për shkak të pengim posedimit.

Në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se : mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i propozon gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 25.07.2024 i padituri ka deklaruar se ekziston leja ndërtimore e lëshuar nga urbanizmi komunal, por edhe përkundër urdhëresës së gjykatës që këtë leje ndërtimore ta dorëzoj në gjykatë, i njëjti nuk e dorëzoj lejen ndërtimore të shtëpisë së vet. Thekson se në shqyrtimin kryesor i cili është mbajtur më datën 05.12.2024 paditësi ka deklaruar se të paditurin e ka djalë të hallës, të njëjtit ia ka dhënë prej oborrit të vet 7 m2, dhe janë marr vesh lidhur me ndërtimin e shtëpisë së të paditurit. Pas kthimit të paditësit nga Zvicra ku jeton dhe punon, i njëjti ka vërejtur se i padituri ka ndërtuar shtëpinë në kundërshtim me marrëveshjen e tyre dhe se i padituri ka kryer aktin e pengim posedimit. Thekson se gjykata për datën 05.12.2024 e kishte ftuar për ta dëgjuar të paditurin, mirëpo i njëjti nuk u paraqit në këtë seancë.

I padituri në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 25.07.2024 ka deklaruar: në parim e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, shton se inspekcioni ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka përpiluar procesverbalin i cili i vihet në shikim gjykatës, si dhe shton se shtëpinë e ka ndërtuar në bazë të projektit të lëshuar nga Komuna e Prizrenit.

Të paditurit edhe pse gjykata ia ka dorëzuar aktvendimin për përgjigje në padi të dt. 02.09.2022 nuk ka paraqitur përgjigje në padi, i njëjti po ashtu edhe pas thirrjeve të rregullta të gjykatës që të marrë pjesë në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore asnjëherë nuk ka qenë prezent përpos shqyrtimit të mbajtur me datë 25.07.2024.

Shqyrtimi kryesor i dt.05.12.2024 është mbajtur në mungesë të palës së paditur të thirrur në mënyrë të rregullt, bazuar në nenin 423 të LPK-së.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: ka bërë leximin certifikatës pronësore të dt. 05.11.2018, leximin e raportit të ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë L.M. të dt. 09.02.2023, leximin e ekspertizës së ekspertes të gjeodezisë A.G. të dt. 16.02.2023 dhe dëgjimin e palës paditëse dhe pas administrimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Nga leximi i certifikatës pronësore të dt. 05.11.2018 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale 4341 ZK Prizren, në sipërfaqe prej 393 m2.

Nga leximi i raportit të ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë L.M. të dt. 09.02.2023, skicës dhe fotove, gjykata ka vërtetuar faktin se ngastra kadastrale 4341 ZK Prizren është pronë e paditësit ku në një pjesë të saj e ka të ndërtuar objektin – shtëpinë dhe një strehë apo “mutfak”, dhe se ngastra kadastrale 4342-1 ZK Prizren është pronë e të paditurit ku në tërë sipërfaqen e ngastrës është në ndërtim e sipër objekti – shtëpia më katshmeri P+1, në ditën e shiqimit “kara japi”. Nga shikimi në vend të ngjarjes shihet se në anën veriperëndimore të shtëpisë së paditurit dhe atë në katin e parë janë të ndërtuara dy ballkone të ndara dhe hapësira – dyer dhe dritare të cilat kanë shikim kah oborri i shtëpisë së paditësit. Në ballkonin e parë vërehet një derë me dimensione 90 x 255 cm, një dritare e banjës me dimensione 60 x 60 cm, ndërsa në ballkonin e dytë vërehet një derë me dimensione 85 x 240 cm dhe një dritare me dimensione 85 x 140 cm.

Nga leximi i raportit të ekspertizës së ekspertes të gjeodezisë A.G. të dt. 16.02.2023, skicës dhe fotove, gjykata ka vërtetuar faktin se parcela nr. 4341 ZK – Prizren gjendet në pjesën juglindore të ZK Prizren. Në një pjesë të kësaj parcele është e ndërtuar një objekt-shtëpi banimi dhe një strehë-shupë e cila është pronë e paditësit, ndërsa në parcelën 4342-1 ZK Prizren e cila është pronë e të paditurit është e ndërtuar një shtëpi me katshmeri P+1, ku në katin e parë janë të ndërtuara dy ballkone të ndara dhe hapësira për dyer dhe dritare të cilat kanë pamje kah oborri i shtëpisë së paditësit. Githashtu parcela 4341 ZK Prizren kufizohet në pjesën veriore me parcelën 4347-0, në pjesën perëndimore me parcelën 4346-0, në pjesën lindore me parcelën 4342-1 dhe 4340-0 si dhe në pjesën jugore me parcelën 4157-0. Sa i përket përshkrimin të gjendjes zyrtare parcela me nr. 4341 ZK Prizren evidentohet në emër të pronarit H.S. dhe sipërfaqja e përgjithshme është 393 m<sup>2</sup>.

Nga dëgjimi i palës paditëse në shqyrtimin kryesor të dt. 05.12.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është në raporte familjare me të paditurin, respektivisht të njëjtin e ka djalë të hallës. Paditësi thekson se ia ka dhënë pëlqimin të paditurit që ta ndërtojë shtëpinë edhe pse përfaqëson 7 metra ka hyrë në pronën e tij. Shton se gjatë ndërtimit të shtëpisë së paditurit ia ka lejuar dritaret kah oborri i tij, por i padituri ka vepruar në kundërshtim me marrëveshjen që e kanë pasur, ngase ka bërë mbi ndërtim ngase ka ndërtuar edhe një kat dhe nënkulm dhe kështu e ka kryer aktin e pengim posedimit duke hapur dritare në një pjesë të katit përdhese dhe katit të parë, si dhe ka ndërtuar edhe terasën e cila shtrihet mbi objektin e shtëpisë së paditësit. Përfundimisht ka deklaruar që i padituri duhet të merr masa që ti mbyll ballkonet në çfarëdo forme teknike që të mos ketë pamje në drejtim të shtëpisë dhe oborrit të tij.

Në bazë të provave të administruara më lartë gjykata ka konstatuar faktin se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale 4341 ZK Prizren, ndërsa i padituri është pronar i ngastrës kadastrale 4342-1 ZK Prizren në të cilën është në ndërtim e sipër shtëpia me katshmeri P+1 në tërë sipërfaqen e ngastrës, se në katin e parë të saj në anën veriperëndimore janë të ndërtuara dy ballkone të ndara dhe hapësira dyer dhe dritare të cilat kanë shikim kah oborri i shtëpisë së paditësit. Gjikata konstaton faktin se i padituri në shtëpinë e tij në ballkonin e parë ka ndërtuar një derë me dimensione 90 x 255 cm dhe një dritare e banjës me dimensione 60 x 60 cm, ndërsa në ballkonin e dytë i padituri ka ndërtuar një derë me dimensione 85 x 240 cm dhe një dritare me dimensione 85 x 140 cm. Gjithashtu gjykata ka konstatuar faktin se këto ndërtime që i ka bërë i padituri kanë pamje kah oborri i shtëpisë së paditësit. Deri te një konstatim i tillë gjykata ka ardhur përmes provave të administruara në këtë procedurë, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të ndërtimitarisë L.M. dhe të gjeodezisë A.G. të cilave prova gjykata i'a fali besimin për shkak se janë të bazuara, në harmoni me provat tjera dhe gjendjen faktike.

Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë dhe duke u bazuar në nenin 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), i cili përcakton se “**Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë**”, në nenin 113 par.1 të po këtij ligji i cili përcakton se: “**Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...**”, ndërsa par. 2 i po këtij neni përcakton se “**Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore**”, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkak se ka konstatuar se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale 4341 ZK Prizren dhe mbi këtë bazë dhe posedues dhe si i padituri ka bërë ndërtime me pamje kah oborri i shtëpisë së paditësit pa pëlqimin e tij i cili dhe me këto veprime ka kryer aktin e pengim posedimit.

Në lidhje me çështjen në fjalë, duke u bazuar në nenin 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata është e kufizuar vetëm në **konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit.**

Gjykata refuzoi si të pa bazuar pretendimin e të paditurit se shtëpinë e ka ndërtuar në bazë të projektit të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, për arsye se gjykata përkundër faktit se e ka obliguar të paditurin që ta dorëzojë procesverbalin e inspektionit dhe lejen ndërtimore lidhur me ndërtimin e shtëpisë të cilat prova ka pretenduar se i posedon, i njëjti edhe përkundër urdhëresës së gjykatës nuk e ka dorëzuar lejen ndërtimore të shtëpisë së vet, madje i padituri pas kësaj urdhërese nga gjykata nuk ka marr pjesë në shqyrtimet gjyqësore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 142.3, e lidhur më nenin 480 të LPK-së.

Në lidhje me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së e lidhur më tarifën e OAK dhe atë për shpenzimet si në vijim: 104 euro në emër të përpilimit të padisë, 50 euro për taksë, për 5 shqyrtime të mbajtura nga 135 euro, dhe shpenzimet për ekspertizën e ndërtimtarisë dhe gjeodezisë nga 150 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,129.00 euro.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZEN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.2386/21, dt. 08.01.2025**

**Gjyqtari,**  
**Shaban Shala**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.